



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Roskovec, më ____ . ____ .2020

NJOFTIM

Lënda : Njoftim për konsultim publik të projekt-vendimeve që do të trajtohen në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Prill 2020.

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015”Për Vetëqeverisjen Vendore”. Neni 18 i tij.Këshilli Bashkiak përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve zhvillon konsultime publike. Në kuadër të këtij procesi,Këshilli Bashkiak publikon në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec (www@bashkiaroskovec.gov.al),në ndërfaqen e Këshillit Bashkiak të gjitha projekt-vendimet që do të kalojnë në procesin e konsultimit publik,sipas parashikimeve të ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” si dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak për konsultimet publike. Për këtë qëllim,mirëpresim cdo koment dhe sugjerim Tuajin,për projekt-vendimet të cilat janë të publikuara si më sipër dhe do të trajtohen në mbledhjen e muajit Prill.Komentet dhe sugjerimet duhet të dërgohen në adresën e-mail :Arlinda.Hajdini@sociale.gov.al,ose me shkresë pranë protokollit të Bashkisë Roskovec brenda datës **26.04.2020**.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin !

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRIS Ë
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

PROJEKT-VENDIM

NR ____ .DATE ____ . ____ .2020

“PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.105 DATË 22.11.2019“PËR MIRATIMIN E PAKETËS FISKALE PËR VITIN 2020”

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Neni 27 Pika 1, Neni 54 gërma f; Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika a dhe c dhe në mbështetje të Urdhërit të Ministrit të Shëndetësis dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 193, date 20.03.2020, “Per parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe semundjeve infektive”

Ju paragesim për diskutim e miratim:

1.1.Ndryshimin në Vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec nr. 105 datë 22.11.2019 “Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2020”, per nje shtyrje te afatit te pagesës si më poshte:

Taksat	Ishte	Propozohet të bëhet
Taksa e tokës bujqësore	Afati i fundit me 30% ulje deri me 30/06/2020	Afati i fundit me 30% ulje deri me 31/08/2020
Taksat dhe tarifatat për bizneset që lejohen të ushtrojne aktivitet	Afati i fundit per pagese deri me 20/04/2020	Afati i fundit per pagese deri me 31/05/2020
Taksat dhe tarifatat per bizneset që nuk lejohen të ushtrojne aktivitet	Afati i fundit per pagese deri me 20/04/2020	Afati i fundit per pagese deri me 30/06/2020

1.2. Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave Vendore, Sektori i Taksave dhe Tarifave Familjare për zbatimin dhe ekzekutimin e këtij vendimi.

2.1. Ndryshimin në vendimin nr 105.datë 22.11.2019“Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2020” i Këshillit Bashkiakë Roskovec te pjesa e II -të Tarifat Vendore, pika II.8 ju bëjmë propozimin për ndryshimin e emërimit të 2 (dy) tarifave si më poshtë:

Ishte	Propozohet të bëhet	
Tarifë për shpenzime varrimi (të rritur)	Tarifë për hapje dhe mbyllje varri (të rritur)	5 000 leke
Tarifë për shpenzime varrimi (të mitur)	Tarifë për hapje dhe mbyllje varri (të mitur)	2 000 leke

2.2. Propozojmë shtesë për tarifë zhvarrimi, në bazë të nenit 18 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 29.10.2014

Tarifa për zhvarrim e cila përmban edhe rivarrimin brenda territorit të Bashkisë Roskovec propozohet:

Tarifë zhvarrimi dhe rivarrimi	10 000 lekë


Në rast se rivarrimi bëhet jashtë territorit të Bashkisë Roskovec tarifa e zhvarrimit bëhet:

Tarifë zhvarrimi	5 000 lekë
-------------------------	-------------------

Të gjitha tarifat e mësipërme janë të llogaritura **pa koston e pllakave të varrit.**

2.3. Ngarkohet Ndërrmarrja e Pastrim, Gjelbërimit dhe Mirëmbajta e Varrezave për zbatimin e këtij vendimi dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, drejtoria e të ardhurave për ekzekutimin e tij.

Konceptoi: D. Goga

D. Dhima 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E TË ARDHURAVE VENDORE

Lënda: Relacion mbi disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak Roskovec nr. 105 datë 22.11.2019

KËSHILLIT BASHKIAK

Roskovec

1. Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Neni 27 Pika 1, Neni 54 gërma f; Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Neni 5, pika a dhe c. Në kuader të situatës së shkaktuar nga COVID- 2019 dhe në mbështetje të Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 193, datë 20.03.2020, “Per parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe semundjeve infektive” në të cilën *ndalohe* *ushtrimi i aktiviteteve në ambiente që ofrojnë shërbime, lokale nate, ambiente të mbyllura të dedikuara për argëtimin e fëmijëve dhe të rinjve, aktivitete palestra, qendra sportive, pishina, qendra interneti, qendra kulturore dhe qendra argëtimi, të njësive të shitjeve në të gjitha Qendrat Tregtare si dhe çdo njesie tjetër që kryhen shitje me pakice të artikujve: industrial, kulturor, veshjeve të llojeve të ndryshme, mallrave artistike, sportive dhe kozmetike.* Në bashkinë Roskovec janë 488 biznese të cilët ushtrojnë aktivitet në vitin 2020. Të cilët janë prekur nga situatat e krijuar nga infeksioni COVID-19, nga 488 biznese 178 biznese përfshihen në listën e bizneseve të cilët nuk lejohen të ushtrojnë aktivitet sipas nr. 193, datë 20.03.2020, “Per parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe semundjeve infektive”

Per këtë arsye drejtoria e të ardhurave vendore propozon shtyrjen e afatit të pageses për bizneset të cilët nuk preken nga urdheri i ministres deri më 31.05.2020 dhe për bizneset të cilët preken nga urdheri i ministres deri më 30.06.2020 kurse për taksapaguesit e tokës bujqësore propozojmë që afati i fundit për pagesën të shtyhet deri më 31.08.2020.

2. Në mbështetje të Ligjit Nr.9220, datë 15.4.2004 “Për administrimin e shërbimit të varrimit” neni 3 pika dh, neni 17 dhe neni 27, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 711, datë 29.10.2014

për miratimin e rregullores “Për administrimin dhe funksionimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”

Në bazë të nenit 18 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 711, datë 29.10.2014 , zhvarrimet e zakonshme kryhen pas lëshimit të lejes së zhvarrimit nga kryetari i njësisë bazë të qeverisjes vendore , pasi personat e interesuar kanë bërë kërkesën. Zhvarrimi bëhet kundrejt një tarife ku sipas nenit 3 pika dh tarifat e shërbimit për varrezat publike miratohen nga këshilli i njësisë bazë përkatëse të qeverisjes vendore.

P/ Taksave dhe Tarifave Familjare

Donika Goga



P/ Biznesit

Ditmira Dhima





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

PROJEKT-VENDIM

NR ____ .DATE 21.04.2020


**“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT ME OBJEKT “REHABILITIM URBAN I
BLLOKUT NR.1”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 4 dhe pika 14, neni 54 gërma k); Ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar ,neni 12 .

Ju paraqesim për diskutim e miratim,

- 1- Projektin me objekt “Rehabilitim Urban i Bllokut Nr.1”
- 2- Pas miratimit të këtij projekt-vendimi në Këshillin e Bashkisë dhe Prefekturën e Qarkut Fier, ngarkohet Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e tij.

Konceptoi: I. Bleta
Miratoi: R. Hazizaj





BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

RELACION SHPJEGUES MBI PROJKETIN

REHABILITIM URBAN I BLOKUT NR 1

Miratohet
Kryetari i Bashkisë
Majlinda Bull

Shtrirja e Bllokut Nr.1 është Jug-Lindje të qytetit të Roskovecit i cili kufizohet nga rrugët Qëndër-Kurjan, Qëndër-Luan Xaxo dhe Unaza ekzistuese Fier-Berat.

Në këtë projekt përfshihen: Reabilitimi i dy rrugëve kryesore të sjellin në qëndër, reabilitimi i fasadave të pallateve ekzistues, reabilitim i rrugës së Shkollës 9-Vjecare Alush Grepca, ndërtimin e një rrugice kalimi pas pallateve si dhe ndërtimin e një parku brenda Bllokut Nr.1.

1.Rruga kryesore Qëndër- Rrethrotullimi Luan Xaxo do ti nënshtrohet disa ndryshimeve si: riparimin e asfltit ekzistues, ndërtim trotuari në të dy anët e rrugës me ndricim dhe gjelbërim, ndërtim KUB, ndërtim i mureve mbajtës atje ku është parë e domosdoshme, ndërtim parkimi, sistemim i shesheve të pallateve si dhe reabilitim i fasadave të pallateve që ndodhen përgjate rrugës.

2.Rruga Qëndër-Kurjan do ti nënshtrohet disa ndryshimeve si: riparimin e asfltit ekzistues, ndërtim, ndërtim parkimi, spostimin e shtyllave elektirke ne segmentin e parkimit , ndërtim kunete, reabilitimin e shesheve para pallateve, veshje me pllaka të shkalleve ekzistuese, ndërtim i një muri mbajtës pas pallateve duke krijuar fragmente për lulishte dhe për sheshe të vogla pas pallateve, ndërtimin e K.U.B për mbledhjen e ujrave, dhe reabilitim i fasadave të pallateve që ndodhen përgjatë rrugës.

3.Rruga e Shkollës 9-Vjecare Alush Grepca do ti nënshtrohet disa ndryshimeve si: asfaltim i rrugës ekzistuese e cila është e dëmtuar, ndërtim trotuari në njërën anë të rrugës, vendosje ndricimi dhe ndërtim K.U.B si dhe ndërtimin e një parkimi në fund të rrugës e cila do tju shërbejë banorëve. Brenda bllokut do të bëhen disa ndryshime për të përmirësuar kushtet e banorëve si: ndricimin e rrugës ekzistuese të shkollës së asfaltuar si dhe asfaltimin e pjesës të pa trjatur më parë.

Gjithashtu brenda bllokut do të bëhet ndërtimi i një parku i cili do të ketë disa funksione. Ky park do të ndërtohet të parku ekzistues me pisha. Në këtë park do të zona relaksi për të rritur dhe fëmijë, do të ketë stola ku të ulen, zona argëtimi për fëmije, pasazhe kalimi të cilat krijojnë dhe hije gjatë diteve të nxehta, një ure e vogël e cila do të shërbeje për kalimin në pjesën tjetër të parkut, do të ketë shumë gjelberim si pemë dhe lule, stola poshtë pemeve për persona të cilët kanë dëshirë të lexojnë nën hijen e pemeve, ndricim neper rrugica dhe brenda parkut, shkalle kalimi te cilat sherbejnë për tu ngjitur ne park, asfaltimin e rrugës që të sjell nga rruga kryesore drejt parkut, reabilitimin e mureve mbajtës, ndërtimin e nje objekti me funksion sherbimi. Ky park lidhet me anë të një rrugice me rrugën e Shkollës e cila bën lidhjen me dy rrugica të tjera drejt një rruge kalimi për këmbësor pas pallateve.




Keto rrugica sherbejnë për të kaluar përmes bllokut nga banorët ose nga persona që kanë dëshirë të vizitojne parkun.

Me realizimin e këtij investimi qytetrët do të përfitojnë një ambjett me standarte bashkëkohore.

Hartoi : Ark. Daniela Kondaj

Ing. Erion Hoxha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

PROJEKT-VENDIM

NR ____ .DATE 02.09.2020

“Për shitjen e pronave të paluajtshme në pronësi të bashkisë Roskovec, për familjet që kanë mbetur të pastreha për shkak të investimit për interes publik dhe përjashtimit nga procesi i legalizimit”

Ne mbështetje të Kodi Civil nenet : 83, 705, 750 dhe 751; të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9 pika 1.2 gërmat 'a' dhe 'c', neni 24 pika 2, neni 54 gërma 'e'; Ligji nr.8743 datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" i ndryshuar , nenet 11 e 12; Ligjit nr.87441 , datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 8 ; të ligjit nr.22,2018 "Për strehimin social" neni 13 pika 1 gërma 'b' paragrafi "iii" , neni 16 , gërma 'a' paragrafi 'vi' , neni 44 pika 2, neni 49 pika 1 ; si dhe Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Roskovec nr.76 datë 18.10.2018 "Për miratimin e investimit për ndërtimin e një godine 3-katëshe për strehim social" dhe nr.84 datë 18.10.2018 "Për pagesën e qerasë për familjet në nevojë", konfirmuar mbi ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr.1720 /1 prot.datë 01.11.2018 ;

Ju paraqesim per diskutim e miratim,

- 1- Propozimin për shitjen e pronave publike në pronësi të bashkisë Roskovec sipas certifikatës së pronësisë , bashkëlidhur.
- 2- Propozimin për shitjen e pronave publike, respektivisht 3 (tre) apartamenteve, familjeve të cilat kanë rezultuar të pastreha si rezultat i zbatimit të pojektit për interes publik "Rikualifikimi urban dhe zhvillimor i bllokut nr.2 , qendra e qytetit Roskovec", banesat e të cilëve prishen për shkak të interesit publik , janë përjashtuar nga procesi i legalizimit dhe qe nuk shpronësohen, konkretisht familjet banore të bashkisë Roskovec, me kryefamiljar:

1-Shkëlqim Begaj
2-Naxhie Driza
3-Fatmir Kasëmaj



3- Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së këtyre pronave të paluajtshme nëpërmjet shitjes, do të kryhet me akt noterial dhe do të regjistrohet sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkelidhur relacioni shpjegues.

Konceptoi.


Sekretar i Pergjithshem

Evisa Mustafaj



KRYETAR

Majlinda Bufi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

Roskovec, më 21.04.2020

Lenda: Relacion shpjegues për projekt-vendimin "Për shitjen e pronave të paluajtshme në pronësi të bashkisë Roskovec, për familjet që kanë mbetur të pastreha për shkak të investimit për interes publik dhe që nuk shpronësohen"

Drejtuar : Keshillit të Bashkisë

Roskovec

Nepermjet ketij propozimi, kerkohet nga ana e Keshillit të Bashkisë Roskovec miratimi për shitjen e pronave të paluajtshme në pronësi të bashkisë Roskovec, për familjet që kanë mbetur të pastreha për shkak të investimit për interes publik dhe që nuk shpronësohen.

Referuar relacionit të komisionit të shpronësimit të bashkisë Roskovec nr.405 datë 21.01.2020 (9bashkëlidhur) , rezulton se në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.19 datë 16.01.2019 janë shpronësuar 27 (njëzetë e shtatë) pasuri si rezultat i zbatimit të projektit për interes publik "*Rikualifikimi urban dhe zhvillimor i bllokut nr.2 , qendra e qytetit Roskovec*".

Më pas me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.705 datë 30.10.2019 u shpronësuan edhe 15 (pesëmbëdhjetë) pasuri të tjera edhe këto si rezultat i zbatimit të projektit për interes publik "*Rikualifikimi urban dhe zhvillimor i bllokut nr.2 , qendra e qytetit Roskovec*".

Pasuritë "shtëpi banimi" të cilat nuk u përfshinë në procesin e shpronësimit ishin pasuritë e poseduara nga z.Shkëlqim Begaj , znj.Naxhie Driza, z.Fatmir Kasëmaj, kjo për shkak se për këto pasuri poseduesit nuk dispononin dokument pronësie apo cdo dokument tjetër që të vërtetonte fillimin e procesit të kalimit të pronësisë.

Ky projektvendim mbështet në ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 9 pika 1.2 gërmat 'a' dhe 'c' , dispozita sipas të cilave njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë të drejtën e pronësisë edhe nëpërmjet shitjes së pronës së paluajtshme dhe kjo është një e drejtë vetëm e organit kolegjial Këshillit Bashkiak.

Pronat që kërkohet t'u shiten këtyre qytetarëve , rezultojnë të regjistruara në emër të Bashkisë Roskovec sipas certifikatave të pronësisë bashkëlidhur.



Në zbatim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë nenet : 83, 705, 750 dhe 751 dhe të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social" neni 13 pika 1 gërma 'b' paragrafi "iii" , neni 16 , gërma 'a' paragrafi 'vi' , neni 44 pika 2, neni 49 pika 1 , veprimi juridik për kalimin e pronësisë së këtyre pronave të paluajtshme nëpërmjet shitjes, do të kryhet me akt noterial dhe do të regjistrohet sipas legjislacionit në fuqi, pasi të jenë përcaktuar nga bashkia: vlera e secilës pronë, mënyra e shlyerjes së vlerës së shitjes, afati i shlyerjes së vlerës së shitjes etj.

Sekretar i Përgjithshëm
Evisa Mustafaj

